



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura IV**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 86

Prishtinë, më 11.7.2013, në orën 13:15

Ndërtesa e Kuvendit, sala S 2

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

**Në mbledhje morën pjesë:** Arben Gashi, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Mufera Shinik.

**Mungoi:** Sreten Ivanović .

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Bajram Gecaj dhe B.M. - USEP, Erëlehta Podaj – Kosova Live, Valon ...RTV 21, Trens Harrold – USEP.

**Nga stafi i Komisionit për Legjislacion:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi,** Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për amnistinë;
3. Të ndryshme .

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

*Rendi ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Shqyrtimi i Projektligjit për amnistinë;**

**Kryetari**, theksoi se me kërkesë të kryesuesit të seancës është thirr kjo mbledhje e Komisionit, për të shqyrtuar Projektligjin për amnistinë, pasi ky projektligj ka kaluar në leximin e parë dhe është kërkuar që edhe leximi i dytë të bëhet sot. Janë bërë disa amendamente nga disa deputetë të Grupit Parlamentarë të PDK-së, nuk e di a do t'i paraqesë dikush nga deputetët, sepse zyrtarisht nuk kemi marr ndonjë amendament dhe kërkoi nga deputetët që ti paraqesin amendamentet nëse kanë.

**Albulena Haxhiu**, shprehu keqardhjen që ky Projektligj ka kaluar në leximin e parë, përkundër kundërshtimeve të shumta nga qytetarët e Republikës së Kosovës dhe deputetët e ndërgjegjshëm të

këtij Kuvendi. Po ashtu, ajo shprehu shqetësimin për shkeljet flagrante që po i bëhen Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit, duke miratuar ligje me procedurë të përshpejtuar.

Ju e dini që sipas rregullores së punës së Kuvendit, pas miratimit në parim, deputetet kanë të drejtë në një afat prej dy javëve, që të dërgojnë amendamente. Është e palogjikshme të kërkohej nga deputetët, që brenda pak minutave të propozojnë amendamentet, kur ne para pak minutave votuam Projektligjin në parim. Përmbajtja kriminale e këtij projektligji është e panegocushme, pasi këtë e ka kërkuar Daçiçi dhe mos u mundoni që t'ju hidhi hi syve qytetarëve dhe shoqërisë civile sepse ka për qëllim amnistimin e krimit dhe strukturave kriminale, prandaj e kundërshtoj fuqishëm miratimin e këtij ligji.

**Armend Zemaj**, tha se unë personalisht por edhe grupi im parlamentar, i kemi dhënë arsyet për ato pjesë të Projektligjit që kanë qenë pengesë dhe që bien ndesh me të drejtën qytetare si dhe për respektimin e rendit dhe ligjit. Unë e kam votuar kundër këtij Projektligji në draftin e parë sepse neni 3, ka rënë ndesh me parimet e mia bazë dhe të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe me interesat e qytetarëve të vendit. Unë sot do të votoj “për”, sepse tashmë janë eliminuar ato parregullsi që ka pas drafti parë e që shihet me heqjen e nenit 3, dhe heqja e atyre dispozitave që nuk do të amnistojë asnjë vrasje.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni me 9 vota “për”, 1 votë “kundër”, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:*

### **Rekomandim**

*Të shqyrtohet dhe të miratohet Projektligji për Amnistinë nr. 04/L-209, pa amendamente.*

Mbledhja përfundoi në orën 13:25  
E përgatiti:  
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit  
**Arben Gashi**

---